



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/060 – 2254

Më: 06 janar 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërres mbledhjen e I/2026 (e parë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **16 janar 2026 (e premte)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Inauguruese të datës 10.12.2025, si dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të datës 24.12.2025;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2026.



Kryesuesi i Kuvendit
Smir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Skupština Opštine Prizren

Br. 001/060 – 2254

Dana: 06 januar 2026

Na osnovu člana 43. Zakona o lokalnoj samoupravi, člana 30. stav 1. i člana 35. stav 2. Statuta općine Prizren, br. 01/011-5643, od 15. oktobra 2008. godine, ovim putem sazivam I/2026. (prvu) redovnu sjednicu Skupštine općine Prizren, koja će se održati: 16. januara 2026. godine (petak), u sali za sastanke Skupštine općine Prizren, u „Bijeloj kući“, s početkom u 10:00 sati.

Stoga ste pozvani, u svojstvu člana Skupštine opštine, da učestvujete u radu ovog sastanka, pridržavajući se navedenom vremenu, datumu i mjestu.

Za rad ovog sastanka predlažem sljedeće:

D N E V N I R E D

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa konstitutivne sjednice od 10.12.2025. godine, kao i sa vanredne sjednice od 24.12.2025. godine;
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Pitanja odbornika i pokretanje raznih pitanja;
4. Razmatranje i usvajanje nacrt odluke o obrazovanju i imenovanju članova Komitet za politiku i finansije;
5. Razmatranje i usvajanje nacrt odluke o obrazovanju i imenovanju članova Komitet za zajednice;
6. Razmatranje i usvajanje nacrt odluke o izboru zamjenika gradonačelnika za zajednice;
7. Razmatranje i usvajanje prijedloga odluke o formiranju radne grupe za izradu plana rada Skupštine općine Prizren za 2026. godinu.



Predsjedavajući Skupštine
Šmir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Belediye Meclisi

No. 001/060 – 2254

Tarih: 06 Ocak 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Özyönetim Kanun'un 43.maddesi, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35. Maddesi, 2. Fıkrası gereğince **16 Ocak 2026 tarihinde (cuma)** saat 10.00'dan başlayarak **"Beyaz Evde"** Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisinin I./2026 (birinci) düzenli oturumu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz:

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir.

GÜNDEM

1. 10.12.2025 tarihli açılış toplantısının ve 24.12.2025 tarihli olağanüstü toplantı tutanaklarının görüşülmesi ve onaylanması;
2. Gündemin görüşülmesi ve kabul edilmesi;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların dile getirilmesi;
4. Siyasi ve Maliye Komite üyelerinin oluşturulması ve adlandırılması için öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
5. Topluluklar Komitesi üyelerinin oluşturulması ve adlandırılması için öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
6. Belediye Topluluklar Başkan Yardımcısının seçilmesi ile ilgili öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
7. 2026 yılına ilişkin Prizren Belediye Meclis çalışma planının tasarlanması için çalışma grubun oluşturulması ile ilgili öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması.



Meclis Başkanı

Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 10 dhjetor 2025, duke filluar nga ora 09:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në mbledhjes ishin të pranishëm 41 anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i zgjedhur i Komunës z.Shaqir Totaj.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e institucioneve, shoqërisë civile si dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Haziz Hodaj, anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Mirëmëngjesi dhe mirëse keni ardhur. I nderuar kryetar i komunës, zoti Shaqir Totaj, të nderuar anëtarë të zgjedhur të kuvendit, i nderuar ish-kryetar i komunës, zoti Ramadan Muja, drejtori i policisë, zoti Faton Aliu, përfaqësuesit e shoqatave të dalë nga lufta, veteranë, familjarët e dëshmorëve, përfaqësuesit e klerit fetar, zonja dhe zotërinj, qytetarët e nderuar të Prizrenit. Më lejoni që në cilësinë e anëtarit më të vjetër të këtij Kuvendi ta shpall të hapur seancën e parë konstituive të Kuvendit Komunal për mandatin e ri. Sa është nder edhe përgjegjësi që sot të udhëheq e të hapë këtë hap të rëndësishëm procedural deri në zgjedhjen e kryesuesit të ri të Kuvendit. Së pari dëshiroj t'ju uroj të gjithë anëtarët të sapo zgjedhur me mandatin e tyre. Rezultati i zgjedhjeve është një shprehje e qartë e vullnetit të qytetarëve tanë, të cilëve u jemi mirënjohës për besimin e dhënë. Ky kuvend ka detyrim që mbi bazat e ligjshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë të punojë për interesin e përgjithshëm të Komunës dhe të gjithë qytetarëve pa dallim. Sot ne nisim me një rrugëtim të ri, me sfida të reja, por edhe me mundësi të reja për ndryshime pozitive, pavarësisht dallimeve politike apo ideologjike, na bashkon detyra për të garantuar mirëqenien, zhvillimin dhe funksionimin efikas të qeverisjes lokale. Në vijim do të procedojmë me pikat e parapara të rendit të ditës, përfshirë verifikimin e mandateve dhe krijimin e kushteve për konstituimin e Kuvendit. Ju ftoj të gjithëve që të kontribuoni me seriozitet, korrektësi dhe frymë bashkëpunimi. Me këtë rast e shpall të hapur seancën konstituive të Kuvendit Komunal dhe ju falënderoj për vëmendjen.

Ashtu siç jeni njoftuar, për këtë mbledhje janë caktuar dy pika të rendit të ditës:

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.
2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës.

Pra, fillimisht do të fillojmë me pikën e parë të rendit i ditës, por para se të gjithash, para se të fillojmë do të duhej që të formohet një komision për verifikimin e mandateve, që në fillim do të duhej të propozohen nga partitë politike, nga partia e parë, nga partia e dytë dhe nga komuniteti joshumicë, domethënë tre anëtarë të cilët do të bëjnë verifikimin e mandateve. Andaj ju ftoj që fillimisht të ketë një propozim nga Partia Demokratike për një anëtar të komisionit. Urdhëro.

Islam Ukaj (PDK): Faleminderit zotëri Hodaj. Partia Demokratike propozon si anëtare të komisionit zonjën Luljeta Veselaj Gutaj.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit shumë. Nga Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Ju faleminderit zotëri Hodaj. Lëvizja Vetëvendosje propozon Karanfil Haxhillari.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit. Një propozim duhet edhe nga komunitetet pakicë që të jetë anëtar i këtij komisioni? Ka ndonjë propozim?

KDTP: Propozohet Furkan Butuci.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Komision prej Luljeta Veselaj Gutaj, Karanfil Haxhillari dhe Furkan Butuci, konsiderohet që është i formuar pasi nuk ka nevojë të votohet, por lus komisionin ta marrë detyrën dhe të verifikoj mandatet dhe verifikoj edhe prezencën e anëtarëve të kuvendit.

Por paraprakisht para se me fillu këtë verifikim ka pasur ndryshime në ndërkohë, tërheqje të disa kandidatëve dhe emërim i të rinjve, andaj do t'i lexoj dhe do të njoftoj kuvendin për këto ndryshime. Anëtarët që kanë dhënë dorëheqje, janë:

1. Tërhiqet Kujtim Gashi, e zëvendëson Behxhat Bytyqi.
2. Tërhiqet Nehat Elshani, e zëvendëson Alban Bislimaj.
3. Tërhiqet Çel Lamaj, e zëvendëson Tefik Tarshaj.
4. Tërhiqet Driton Selmanaj, e zëvendëson Astrit Temaj.
5. Tërhiqet Besnik Krasniqi, e zëvendëson Agim Muçaj.
6. Tërhiqet Haxhi Avdyli, e zëvendëson Petrit Hoxhaj.
7. Tërhiqet Rasim Demiri, e zëvendëson Eldis Abazi.
8. Tërhiqet Duda Balje, e zëvendëson Dzengis Saliji.
9. Tërhiqet Emilia Redzepi zëvendësohet nga Zikreta Aliti.

Po konsideroj që të emëruarit të rinj janë prezentë dhe do t'i bashkëngjiten betimit bashkë me anëtarë të tjerë të kuvendit.

Nëse kur janë gati anëtarët e komisionit, njëri prej tyre duhet me deklaru, me raportu se si është gjendja.

Luljeta Gutaj Veselaj (Anëtare e Komisionit): Të nderuar anëtarë të Kuvendit, i nderuar Kryetar i Komunës, të gjithë ju të pranishëm. Fillimisht uroj që ky mandat të jetë i shëndetshëm dhe i suksesshëm për secilin anëtar të Kuvendit. Punë të mbarë dhe të mira për Kryetarin e Komunës dhe ekipet të tjera shoqëruese. Bazuar në komisionin për verifikimin e mandateve, ne konstatojmë se mbas ligjit të gjitha mandatet e verifikuara janë në rregull. Urime, suksese, punë të mbarë.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit zonja Gutaj Veselaj, pasi që komisioni konstaton se të gjitha mandatet e anëtarëve të pranishëm janë verifikuar sipas dokumentacionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, atëherë ju ftoj që të ngritemi në këmbë si anëtarë të Kuvendit për dhënien e betimit. Sigurisht që e dini që betimi lexohet pjesë-pjesë nga unë si kryesues i seancës dhe përsëritet nga të gjithë anëtarët.

Sevil Kazaz (YTHP): Propozoj për me lexu betimin, komuniteti boshnjak edhe komuniteti turk veç a veç në gjuhën e tyre.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Okej, unë unë do ta lexoj në gjuhën shqipe, pastaj ju vini edhe lexoni vetë në gjuhën. në gjuhën përkatëse. Kështu që nuk ka asnjë problem në këtë drejtim. Atëherë kur thashë keq tu sqaru, kur vjen puna te emri e thoni secili emrin e vet sigurisht, kështu që mos betoheni në emrin tim të gjithë, se unë e them me emrin tim e ju të juajin duhet të thënë.

Atëherë nëse jeni gati, teksti i betimit është “ Unë, _____, “betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mija si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Atëherë betohemi dhe ju lus t'i nënshkruani betimet dhe t'i lini në tavolinë. Domethënë ju vyen, i kërkohet nga administrata që t'i kenë në dosjet e veta. Dhe pas betimit juaj urime dhe njëherë, na shkoftë mbarë dhe paqim një mandat të suksesshëm dhe pas kësaj natyrisht të ftoj edhe kryetarin e komunës për dhënien e betimit dhe të nënshkruaj deklaratën e këtij betimi.

Komuniteti boshnjak edhe turk lexojnë betimin në gjuhën e tyre. Në fillim komuniteti boshnjak pastaj turk.

Ja, _____, "zaklinjem se (ili svečano izjavljujem) da ću svoje dužnosti obavljati časno, odano, nepristrasno i savjesno i u skladu sa zakonom, te da ću svoja ovlaštenja kao odbornik Skupštine opštine Prizren koristiti kako bih osigurao uslove za miran život za sve."

Ben, _____, “Prizren Belediye Meclis üyesi olarak herkes için sakin yaşam koşulları sağlamak amacıyla yetki ve görevlerimi onurlu, sadakatli, tarafsız, vicdanlı ve hukuka uygun olarak yerine getireceğime ant içerim (veya beyan ederim)”.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): E ftoj kryetarin e komunës për betimin solemn.

Shaqir Totaj (Kryetar i zgjedhur i Komunës): Të nderuar të pranishëm, Unë, Shaqir Totaj, “betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtrojë kompetencat e mia si kryetar i komunës së Prizrenit, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë”.

E kam nënshkruar pak më herët, kështu që s'ka nevojë tash me nënshkru.

Haziz Hodaj: Faleminderit, urime kryetar. Atëherë të ftoj edhe për një fjalë rastin, ndoshta.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Po, të nderuar asambleistë të gjitha partive pa dallim, së pari dua me ju uru juve edhe me ju dëshiru sukses. Pastaj një përshëndetje të veçantë për të gjithë mysafirët që i kemi këtu, përfaqësuesit e institucioneve, përfaqësuesit të klerit fetar, një përshëndetje pak më të veçantë për fluturën edhe për Adonisin edhe për Elmën, për familjen time, po edhe shumë mysafirë që i kemi këtu. Është një momentum i një fillimi të ri të mandatit të dytë, të gjithë jemi së bashku këtu në një qytet emblematic të kombit për të punuar për një të ardhme më të mirë, konsideroj që objektivi ynë është shumë më i madh sesa dallimet e vogla partiake që mund t’i kemi. Unë ju siguroj që do të punoj pa dallime edhe do të jem kryetar i të gjithëve dhe i atyre që nuk kanë votuar për mua. Jam shumë i sigurt që bashkë jemi më të fortë edhe jam shumë i sigurt që bashkë do të dimë të ruajmë identitetin e qytetit të Prizrenit, e identiteti i qytetit të Prizrenit është diçka që na bën krenarë të gjithëve neve. Është krenari me qenë qytetar i Prizrenit, është krenari me qenë asambleist i Prizrenit e sidomos me qenë kryetar i Prizrenit. Du me i falënderu të gjithë votuesit që ma kanë dhënë këtë privilegj. Edhe le të vazhdojmë bashkë për një katërvjeçar të suksesshëm, të bëjmë më të mirën e mundshme për qytetin e Prizrenit edhe jam shumë i sigurt që rezultati nuk do të na mungojë. Do t’ju falënderoj të gjithëve paraprakisht për bashkëpunimin që e kemi pasur dhe për bashkëpunimin që do të kemi edhe vazhdojmë drejt një kontributi për jetë më të mirë, në një qytet të veçantë sikurse është Prizrenit. Ju falënderoj të gjithëve për vëmendjen.

Haziz Hodaj: Faleminderit kryetar. Faleminderit ty edhe suksese. Faleminderit të gjithë anëtarëve të Kuvendit, të gjithë mysafirëve pjesëmarrës dhe me këtë rast e shpall të përfunduar këtë seancë solemne. Edhe njëherë na shkoftë mbarë ky mandat. Shpresoj që qytetarët e Prizrenit do të jenë të kënaqur me punën që do ta bëjmë. Faleminderit shumë.

Mbledhja përfundoi më 09:30.

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 24 dhjetor 2025, duke filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në mbledhjes ishin të pranishëm 41 anëtarët e të Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës z.Shaqir Totaj.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Haziz Hodaj, anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Atëherë, mirëmëngjes, përshëndetje për të gjithë. Përshëndetje për Kryetarin e Komunës edhe po e shfrytëzoj rastin që nëpërmes kësaj foltore me ja uruar ditëlindjen sot. Me ju uru shëndet edhe punë të mbarë në edhe në mandatin e ri. Përshëndes anëtarët e zgjedhur të Kuvendit, Nënkryetarin e komunës, përfaqësues të medias, të shoqërisë civile, dhe mysafirë të tjerë që janë prezent në sallë. Siç e dini, mbledhja është thirrje jashtëzakonshme me kërkesën e kryetarit të komunës me një pikë të vetme të rendit ditës, zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të komunës. Konstatohet se kuorum ka, domethënë janë 41. Po të gjithë anëtarët të Kuvendit prezent dhe pa humbur kohë ne mund të fillojmë dhe të procedojmë me procedurën e zgjedhjes së kryesuesit, por paraprakisht do të ftoja zyrtarin ligjor të kuvendit që të sqarojë mënyrën e zgjedhjes së kryesuesit. Urdhno.

Arbër Krasniqi (Zyrtar i shërbimit të Kuvendit): Përshëndetje i nderuar kryesues i seancës, kryetar i komunës, nënkryetar, anëtarë të kuvendit dhe të gjithë të pranishëm. Atëherë, të nderuar anëtarë të kuvendit para jush do të sqaroj procedurat për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale si dhe me Udhëzimin Administrativ nr. 2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të kuvendit të komunës. Në përputhje me dispozitat ligjore, Kuvendi i Komunës duhet që 30 ditë pas konstituimit të kuvendit të zgjedhë kryesuesin nga radhët e anëtarëve të tij. Nëse brenda këtij afati Kuvendi nuk e zgjedh kryesuesin, atëherë kuvendi konsiderohet jo-funksional. Procedura për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit fillon me propozimin e kandidatëve për kryesues. Çdo subjekt politik, nismë qytetare apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në kuvendin e komunës ka të drejtë të propozojë një kandidat për

kryesues. Pasi të përfundojë procedura e propozimeve të kandidatëve, Kuvendi me shumicë të thjeshtë formon një komision për mbarëvajtjen e procesit të votimit në përbërje prej 3 deri 5 anëtarë të Kuvendit të Komunës. Komisioni është përgjegjës për numërimin e votave dhe komunikimin e rezultateve, para anëtarëve të kuvendit. Votimi për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit bëhet me vota të fshehta dhe procedura e votimit është paraparë të zhvillohet deri në tre raunde në rast se kandidatët nuk sigurojnë shumicën e kërkuar.

- Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
- Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjedhet kryesues i kuvendit të komunës.
- Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, atëherë shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë kryesues i Kuvendit të Komunës zgjedhet kandidati, i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet kryesuesi i kuvendit, atëherë i tërë procesi përsëritet nga fillimi.

Ju falënderoj për dëgjim.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit Arbër. Atëherë shkojmë menjëherë me propozimin e kandidatëve dhe do të ftoja partitë politike në radhë të parë Partisë Demokratike të Kosovës që që të propozojë ë një kandidat për kryesues të kuvendit.

Arianit Berisha (PDK): Përshëndetje të gjithëve, i nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar, të nderuar kolegë kuvendarë, të nderuar të pranishëm, në emër të grupit kuvendarëve të Partisë Demokratike të Kosovës, kam kënaqësinë që ta propozoj zotëri Simir Krasniqin për kryesues. Një biografi të shkurtër për Simirin. Simiri është i lindur në Jeshkovë. Ka gradën shkencore doktor i shkencës në shkencat mjedisore. Ka një përvojë të gjatë në arsimin parauniversitar dhe universitar. Gjithashtu i njëjti ka qenë kuvendar i Prizrenit në mandatin 2017-2021, ku e ka ushtruar edhe detyrën e shefit të grupit. Pastaj në mandatin 2021-2023 ka qenë kuvendar i Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa nga viti 2023 deri në vitin 2025 ka shërbyer si drejtor i shëndetësisë. Prandaj propozimi i Partisë Demokratike të Kosovës është Simir Krasniqi për Kryesues të Kuvendit. Faleminderit.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit. Partitë tjera politike, Lëvizja Vetëvendosje ka propozim?

Dafina Alishani (LVV): Përshëndetje kryesues. Lëvizja Vetëvendosje nuk ka propozim.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit Lidhja Demokratike nuk ka gjithashtu. Tjetër propozim nga anëtarët e kuvendit? Po konstatoj se nuk ka propozime të tjera. Paraprakisht para se me fillu procedurën do të duhej me formu një komision prej tre deri në pesë anëtarë që do ta zhvillonin, do ta udhëhiqnin procedurën e zgjedhjes së kryesuesit. Partia Demokratike?

Arianit Berisha (PDK): Në emër të Partisë Demokratike e propozoj kuvendaren Luljeta Gutaj Veselaj që të jetë anëtare e komisionit.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit. Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje propozoj Adem Shabanaj.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit. Atëherë a do të shkojmë me tre apo me më tepër kandidat? Cili është Po po patjetër, patjetër. Nuk e harrojmë komunitetin, këtu jemi. Atëherë shkojmë me një propozim nga komunitetet Pakicë.

Furkan Butuci (KDTP): Propozojmë Sevilja Igci Hapçi

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Atëherë unë po konstatoj që nuk ka të interesuar nga Lidhja Demokratike, nga anëtarë të tjerë të kuvendit që të ketë më tepër anëtarë të komisionit, shkojmë me tre anëtarë. Urdhëro zoti Quni.

Shukri Quni (BDP): Kemi anëtarë të tjerë këtu. Unë thashë a keni unë Kryesues, unë thashë mos po shkon me rend aty te të gjitha partitë. Përshëndetje kryesues. Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë kuvendarët. Edhe ne Partia e Bashkimit Demokratik e kemi domethënë kandidatin, është Sefidin Islamaj.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit shumë. Atëherë tash duhet me shku me numër tek apo edhe katër? Edhe një. Atëherë nga Lidhja Demokratike le të jetë edhe një propozim edhe shkojmë me pesë anëtarë të komisionit.

Qemal Krasniqi (LDK): Grupi i kuvendarëve të LDK-së propozon Agnesa Sinanaj.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit shumë. Gjithsesi ky komision duhet të votohet sepse tash jemi të betuar dhe kemi drejt vote. Kështu që po kërkoj që komisioni i propozuar prej: Luljeta Veselaj, Adem Shabanaj, Sevilja Igci Hapçi, Sefedin Islamaj dhe Agnesa Gavazaj Sinanaj. Atëherë kërkoj që të votohet ky komision dhe të shkohet në proces të votimit mandej. Kush është për? Atëherë konstatoj që Unanimisht do zgjedh komisioni për zgjedhjen e kryesuesit. Kisha kërkuar ja pesë minuta, eventualisht 10 minuta pauzë derisa shërbimet t'i përgatitin teknikisht flet votimet. 10 minuta pauzë. Komisioni le të tërhiqet në vendet e tyre dhe të fillojnë punën.

Pas pauze

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Atëherë, unë po konsideroj që komisioni ka kryer punën e vetë të përgatitjes teknike dhe të gjithë janë prezent anëtarë të kuvendit, kështu që mund të fillojmë menjëherë me procedurat e votimit.

Adem Shabanaj (Anëtar i Komisionit): Mirë, atëherë përshëndetje për të gjithë, të nderuar kolegë kuvendar, i nderuar kryetar i komunës, kryesues i kësaj seance, media dhe ju të pranishëm.

Kërkoj mirëkuptimin tuaj meqenëse Selman Sokoli është me punë në Prishtinë edhe po kërkon që të tejkalojë radhitjen alfabetike, të votojë i pari. Nëse nuk ka ndonjë problem kisha filluar me Selmanin. A pajtoheni? Atëherë ftoj :

Selman Sokolin. Le të përgatitet:

Adem Morina

Adem Shabanaj

Agim Muqaj

Agnesa Sinanaj Gavazaj

Alban Bislimaj

Albulena Balaj Halimaj

Arianit Berisha

Astrit Temaj

Bexhat Bytyqi

Dafina Alishani

Dea Gavazaj

Drita Qenaj

Driton Sallauka

Dzengis Saliji

Eldis Abazi

Endrit Zogaj

Florent Ukaj

Furkan Bütüçi

Haziz Hodaj

Ilir Gashi

Islam Ukaj

Karanfil Haxhillari

Liridona Veçgishti

Luljeta Veselaj Gutaj

Mergiton Gavazaj

Mimoza Memaj

Nazife Kokollari

Nerimane Pllana Gashi

Petrit Hoxhaj

Qemal Krasniqi

Sefidin Islamaj

Sevil Kazazi

Sevilya Igci Hapçi

Shqipe Shatri Çoçaj

Shukri Quni

Simir Krasniqi

Tefik Tarashaj
Ymran Fusha
Zgjim Kryeziu
Zikreta Aliti.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): A kanë votuar të gjithë? Po. Atëherë filloni me procedurën e numërimit edhe le të jenë transparent numërimi. Për anëtarët e komisionit jam duke folur. Filloni procesin e numërimit edhe le të jenë transparent gjatë numërimit.

Luljeta Veselaj Gutaj (Anëtare e Komisionit): Kolegë të nderuar, përshëndetje për të gjithë, i nderuar Kryetar i Komunës. Komisioni pas votimit dhe pas verifikimit nga 41 anëtarë të kuvendit sa morën pjesë në votim, 41 fletvotime janë të vlefshme. Vazhdojmë me procesin e votimit, si kanë votuar! Ju lutem një nga anëtarët e komisionit të mbajë proces dhe të bëjë numërimin e votave.

Pra pas konstatimit të komisionit verifikues, nga 41 anëtarë të Kuvendit, të cilët votuan, 29 anëtarë të Kuvendit kanë votuar Për Simir Krasniqin kryesues të Kuvendit, 11 kanë votuar Kundër, kurse 1 është Abstenim. Urime, shëndet dhe suksese kryesuesi i Kuvendit në komunën e Prizrenit, zoti Simir Krasniqi.

Haziz Hodaj (Kryesues i Mbledhjes): Faleminderit anëtareve të komisionit. Atëherë, urime Kryesuesit të ri dhe thërras ta merr vendin dhe ta kryesoj këtë Kuvend. Po shpresojmë ashtu si duhet. Faleminderit edhe njëherë për procesin korrekt.

Simir Krasniqi (Kryesues i zgjedhur i Kuvendit): I nderuar Kryetar i Komunës së Prizrenit zoti Shaqir Totaj. I nderuar kryesues i kësaj seance të Kuvendit Komunal zoti Haziz Hodaj. Të nderuar kuvendarë të kësaj legjislature të re, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile, të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit dhe ju të pranishëm në këtë seancë. Të nderuar kuvendarë nga të gjitha subjektet politike këtu në Kuvend, ju faleminderit për votën tuaj, që më dhatë besimin që të jem Kryesues i Kuvendit Komunal të Komunës së Prizrenit. Përgjegjësia ime, si Kryetar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, më bën të ndihem edhe më përgjegjës para qytetarëve të Komunës sonë. Zotohem se do t'i zbatoj plotësisht të gjitha kërkesat për të gjitha subjektet politike të Komunës së Prizrenit do të jem bashkëpunues me të gjithë pa dallim partie, të gjitha ata kërkesa të qytetarëve pra do t'i përcjellim bashkërisht gjatë këtij mandati katërvjeçar. Do të bashkëpunoj me të gjitha komitetet, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete, Komitetet obligative që ky Kuvend të jetë sa më produktiv dhe sa më frymëzues që të gjitha punët, të gjitha vendimet dhe rregulloret të jenë në nivel me ligjin për vetëqeverisjen lokale, rregulloren e Kuvendit dhe statutin e Kuvendit. Dhe për fund ju faleminderit pra të gjitha subjekteve politike në Kuvendin Komunal të Prizrenit. Ju faleminderit të gjithëve.

Vazhdojmë pra me radhë, duke u mbështetur në dispozitat e ligjit për vetëqeverisje lokale të kuvendit të komunës, ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komunitetit jo shumicë, pra, posti i zëvendës kryesuesit i takon asaj partie sipas KQZ-së, e cila ka marrë numrin më të madh të votave.

Dhe në këtë rast, pra, ftojme zotin Furkan Butuç që të merr pozitën e zëvendës kryesuesit të Kuvendit Komunal. Urime. Pra ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe në fund dua të ju uroj festat e fundvitit dhe vitin e ri të gjithëve juve që jeni këtu në sallë dhe të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit dhe uroj që viti 2026, të jetë i shëndetshëm, të sjellë mbarësi dhe gjithë të mirat për ju dhe gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit. Dhe këtë seancë e llogarisim të mbyllur pra, vazhdojmë me seancat tjera. Ju faleminderit.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40

Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës së Prizrenit
Nr. 001/011 –
Më: 000..... 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafit 1, 2, shkronja d), nenit 51 paragrafit 1 dhe nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 3, 4, 5, nenit 6 paragrafit 3 dhe nenin 12 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020, për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 6 paragrafin 7 dhe 8 të Ligjit Nr.05/L-20 për Barazi Gjinore, si dhe nenin 27 paragrafit 1, nenit 58 paragrafit 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643 dt. 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 00....., miratoi këtë:

VENDIM
PËR THEMELIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR
POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

1. Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa si komitet i përhershëm, në përbërje prej nëntë (9) anëtarëve.
2. Anëtar/e të Komitetit për Politikë dhe Financa, emërohen:
 - 2.1. – Kryesues,
 - 2.2..... – anëtar/e nga PDK;
 - 2.3..... – anëtar/e nga PDK
 - 2.4..... – anëtar/e nga PDK
 - 2.5..... – anëtar/e nga LVV
 - 2.6..... – anëtar/e nga LVV
 - 2.7..... – anëtar/e nga LDK
 - 2.8..... – anëtar/e nga LDK
 - 2.9..... – anëtar/e nga BDP

Neni 2

Detyra, Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Politikë dhe Financa do të jenë ashtu siç janë përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011 5643, të datës 15 tetor 2008, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Mandati i anëtareve të Komitetit për Politikë dhe Financa është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Skupština općine Prizren
Br. 001/011 –
Datum: 000..... 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 12, stav 1, 2, slovo d), člana 51 stav 1 i člana 52 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članova 3, 4, 5, člana 6 stav 3 i člana 12 stav 1 Administrativnog uputstva (MPL) br. 05/2020, o postupku za osnivanje, sastav i nadležnosti stalnih odbora i drugih odbora u općini, člana 6 stav 7 i 8 Zakona br. 05/L-20 o ravnopravnosti spolova, kao i člana 27 stav 1, člana 58 stav 1 Statuta općine Prizren br. 01/011-5643 od 15. oktobra 2008. godine, Skupština općine, na svojoj redovnoj sjednici održanoj 00.... godine, odobrila je sljedeće:

ODLUKA

O OSNIVANJU I IMENOVANJU ČLANOVA KOMITET ZA POLITIKU I FINANSIJE

Član 1

1. Komitet za politiku i finansije se ovim osniva kao stalni odbor, koji se sastoji od devet (9) članova.
2. Ovim se imenuju sljedeći članovi Komitet za politiku i finansije:
 - 2.1. – predsjedavajući,
 - 2.2. – član PDK
 - 2.3. – član PDK
 - 2.4. – član PDK
 - 2.5. – član LVV
 - 2.6. – član LVV
 - 2.7. – član LDK
 - 2.8. – član LDK
 - 2.9. – član BDP

Član 2

Dužnosti, ovlaštenja i odgovornosti Komitet za politiku i finansije definirane su Zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Administrativnim uputstvom (MPL) br. 05/2020 o postupku za osnivanje, sastav i ovlaštenja stalnih odbora i drugih odbora u općini, Statutom općine Prizren br. 01/011 5643 od 15. oktobra 2008. godine, kao i drugim važećim zakonskim i podzakonskim aktima.

Član 3

Mandat članova Komitet za politiku i finansije povezan je s mandatom odbornika Skupštine općine.

Član 4.

Ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon podnošenja nadzornom organu, u smislu člana 8., u vezi sa članom 9. Zakona br. 08/L-284 o administrativnom preispitivanju opštinskih akata, i nakon objavljivanja na službenim jezicima na službenoj web stranici opštine.

**Predsjedavajući Skupštine
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Prizren Belediye Meclisi
No. 001/011 –
Tarih: 000..... 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

03/L-040 Sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 12. Maddesi, 1,2. Fıkrası, d) noktası, 51. Maddesi, 1. Fıkrası, 52. Maddesi, Belediye'nin Daimi ve Diğer Komitelerinin Kurulması, Oluşumu ve Yetki Süreçleri ile ilgili 05/2020 sayılı (YYB) İdari Yönergesinin 3,4,5 ve 6. Maddeleri, 3. Fıkrası, 05/L-20 sayılı Cinsiyet Eşitliği Yasası'nın 6. Maddesi, 7 ve 8. Fıkrası ve Prizren Belediye Tüzüğü'nün 27. Maddesi, 1. Fıkrası, 58. Maddesi, 1. Fıkrası gereğince Belediye Meclisi 00 tarihinde düzenlediği düzenli toplantıda aşağıda yer alanları onayladı:

SİYASİ VE MALİYE KOMİTE ÜYELERİNİN OLUŞTURULMASI VE KURULMASI İLE İLGİLİ KARAR

Madde 1

1. İşbu karar ile (9) üyeden oluşan Siyasi ve Maliye Komitesi oluşturulmuştur.
2. Siyasi ve Maliye Komitesi aşağıda yer alanlardan oluşacaktır:
 - 2.1.Başkan,
 - 2.2.PDK' dan Üye.....
 - 2.3.PDK' dan Üye.....
 - 2.4.PDK' dan Üye.....
 - 2.5.LVV' dan Üye.....
 - 2.6.LVV' dan Üye.....
 - 2.7.LDK' dan Üye.....
 - 2.8.LDK' dan Üye.....
 - 2.9.BDP' dan Üye.....

Madde 2

Siyasi ve Maliye Komite üyelerinin görev, yetki ve sorumlulukları 03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'u, Belediye'nin Daimi ve Diğer Komitelerinin Kurulması, Oluşumu ve Yetki Süreçleri ile ilgili 05/2020 sayılı (YYB) İdari Yönergesi, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011 5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü, yürürlükteki diğer yasa ve alt yasa akdi ile öngörülenlerdir.

Madde 3

Siyasi ve Maliye Komite üyelerinin görev süresi Belediye Meclis üyelerin mevcut görev süreleri ile bağlantılıdır.

Madde 4

Söz konusu karar Belediye Aktların İdari İncelemesi ile ilgili 08/L-284 sayılı yasanın 9. Maddesi ile bağlantılı olan 8. Maddeye istinaden denetleme organına iletdikten 30 gün sonra ve Belediyenin resmi web sayfasında resmi dillerde iletdikten sonra yürürlüğe girer.

Meclis Başkanı
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi i Komunës së Prizrenit

Nr. 001/011 –

Më: __ janar 2026

Në bazë të nenit 12, paragrafit 1, 2, pika d), nenit 51 paragrafit 1 dhe neni 53 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neneve 3, 7, 8, 9 dhe neni 12 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020, Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 6 paragrafin 7 dhe 8 të Ligjit Nr.05/L-20 për Barazi Gjinore, si dhe nenin 27 paragrafit 1, neni 58 paragrafit 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643 dt. 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më __ janar 2026, miratoi këtë:

PROPOZIM-VENDIM

PËR THEMELIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Komunitete si komitet i përhershëm në përbërje prej __ anëtarëve.
2. Anëtar/e të Komitetit për Komunitete emërohen:

Neni 2

Detyra, Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Komunitete do të jenë ashtu siç janë përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011 5643, të datës 15 tetor 2008, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

3.1 Nga përbërja e anëtarëve, vetë anëtarët e Komitetit në mbledhjen e parë me shumicë votash do ta zgjedhin Kryesuesin/ën e Komitetit.

3.2 Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



**Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Skupština općine Prizren

Br. 001/011 –

Datum: __ januar 2026.

Na osnovu člana 12. stav 1, 2, tačka d), člana 51. stav 1 i člana 53. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članova 3, 7, 8, 9 i člana 12. stav 1 Administrativnog uputstva (MPL) br. 05/2020 o postupku za osnivanje, sastav i nadležnosti stalnih odbora i drugih odbora u općini, člana 6. stav 7 i 8. Zakona br. 05/L-20 o ravnopravnosti spolova, kao i člana 27. stav 1, člana 58. stav 1 Statuta općine Prizren br. 01/011-5643 od 2003. godine. Skupština općine je, na svojoj redovnoj sjednici održanoj __. januara 2026. godine, 15. oktobra 2008. godine, odobrila sljedeće:

PRIJEDLOG ODLUKE O FORMIRANJU I IMENOVANJU ČLANOVA KOMITET ZAJEDNICE

Član 1

1. Ovom odlukom se osniva Komitet za zajednice kao stalni odbor sastavljen od __ članova.
2. Imenuju se sljedeći članovi Komitet za zajednice:

Član 2

Dužnosti, nadležnosti i odgovornosti Komitet za zajednice definirane su Zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Administrativnim uputstvom (MPL) br. 05/2020 o postupku za osnivanje, sastav i nadležnosti stalnih odbora i drugih odbora u općini, Statutom općine Prizren br. 01/011 5643 od 15. oktobra 2008. godine, kao i drugim važećim zakonskim i podzakonskim aktima.

Član 3

- 3.1 Iz sastava članova, sami članovi komitet, na prvoj sjednici, većinom glasova, biraju predsjedavajućeg Odbora.
- 3.2 Mandat članova Komitet za zajednica vezan je za mandat odbornika Skupštine općine.

Član 5.

Ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon podnošenja nadzornom organu, u smislu člana 8., u vezi sa članom 9. Zakona br. 08/L-284 o administrativnom preispitivanju opštinskih akata, i nakon objavljivanja na službenim jezicima na službenoj web stranici opštine.

**Predsjedavajući Skupštine
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Prizren Belediye Meclisi

No. 001/011 –

Tarih: __ Ocak 2026

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 12. Maddesi, 1 ve 2. Fıkrası, d) noktası, 51. Maddesi, 1. Fıkrası, 53. Maddesi, Belediyede Daimi Komitelerin ve diğer Komitelerin Kurulması, Oluşturulması Prosedürüne ilişkin 05/2020 sayılı İdari Yönergenin (MPL) 3,7,8,9. Ve 12. Maddesi, 1. Fıkrası, 05/L-20 sayılı Cinsiyet Eşitliği yasasının 6. Maddesi, 7 ve 8. Fıkrası ve 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 27. Maddesi, 1. Fıkrası, 58. Maddesi, 1. Fıkrası gereğince Belediye Meclisi ocak 2026 tarihinde düzenlediği toplantıda aşağıda yer alanları onayladı:

TOPLULUKLAR KOMİTESİ ÜYELERİNİN OLUŞTURULMASI VE ADLANDIRILMASI İLE İLGİLİ ÖNERİ – KARAR

Madde 1

1. İşbu karar ile ____ üyeden oluşan daimi komite olarak Topluluklar Komitesi oluşturulmuştur.
2. Topluluklar Komitesi üyeleri olarak aşağıda yer alanlar adlandırılmıştır:

Madde 2

Topluluklar Komitesi üyelerinin görev, yetki ve sorumlulukları 03/L-040 sayılı Yerel Özyönetim Kanunu, Belediyedeki Daimi Komitelerin ve Diğer Komitelerin Kuruluşu, Oluşumu ve Yetki Süreçleri Hakkında 05 / 2020 sayılı İdari Yönerge (YYB), 01/011 5643 sayı ve 15 Ekim 2008 tarihli Prizren Belediye Tüzüğü ve yürürlükteki diğer yasal ve alt yasal düzenlemeler ile öngörüldüğü şekilde olacaktır.

Madde 3

3.1 Üyelerin oluşumundan, Komite üyeleri kendileri ilk toplantıda oy çoğunluğu ile Komite Başkanını seçeceklerdir

3.2 Topluluklar Komitesi üyelerinin görev süresi, Belediye Meclisi üyelerinin mevcut görev sürelerinin sona ermesiyle veya Belediye Meclisinin herhangi bir başka kararıyla sona erer.

Madde 5

Söz konusu karar Belediye Aktların İdari İncelemesi ile ilgili 08/L-284 sayılı yasanın 9. Maddesi ile bağlantılı olan 8. Maddeye istinaden denetleme organına iletdikten 30 gün sonra ve Belediyenin resmi web sayfasında resmi dillerde iletdikten sonra yürürlüğe girer.

Meclis Başkanı
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 007/26 Dt. 06.01.2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragraf 2, pika d) dhe nenit 61 paragraf 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2023 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komunë, neni 27 paragraf 1 dhe nenit 54 paragraf 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më ___ janar 2026, miratoi këtë:

**PROPOZIM-VENDIM
PËR EMËRIMIN E NËNKYETARIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR
KOMUNITETE**

1. Nënkyetar i Komunës së Prizrenit për Komunitete, emërohet
2. Mandati i Nënkyetarit të Komunës së Prizrenit për Komunitete, do të jetë i njëjtë sikurse i Kryetarit të Komunës.
3. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete do të jenë ashtu siç janë paraparë me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Me këtë Vendim do të njoftohen: Nënkyetari i emëruar, MAPL-ja, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financa dhe Arkivi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Propozuesi:
Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011 -
Më: Janar 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë nenit 12, paragrafit 1, 2, pika d), nenit 51 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 27 paragrafit 1, nenit 58 paragrafit 2 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643 dt. 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më janar 2026, miratoi këtë:

PROPOZIM-VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN PLANIT TË PUNËS TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2026

Neni 1

Me këtë vendim, formohet dhe emërohet grupi punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2026.

Neni 2

1. Pjesë e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës, do të jenë Kryesues i Kuvendit dhe nga një anëtarë nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, sikurse në vijim:
 - 1.1., Kryesues i Kuvendit
 - 1.2....., anëtar nga PDK
 - 1.3., anëtar nga LVV
 - 1.4., anëtar nga LDK;
 - 1.5....., anëtar nga BDP;
 - 1.6., anëtar nga AAK;
 - 1.7., anëtar nga KDTP;
 - 1.8., anëtar nga NISMA;
 - 1.9....., anëtar nga GUXO
 - 1.10., anëtar nga NDS;
 - 1.11., anëtar nga VAKAT
 - 1.12., anëtar nga SDU dhe
 - 1.13., anëtar nga YTHP.

Neni 3

Grupi Punues, ka për detyrë ta hartoj planin e punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2026, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe të njëjtin ta sjellë për miratim në Kuvendin e Komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Skupština općine

Br. 001/011 -

Datum: januar 2026.

Na osnovu člana 12. stav 1, 2. tačka d), člana 51. stav 2. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, kao i člana 27. stav 1, člana 58. stav 2. Statuta općine Prizren, br. 01/011-5643 od 15. oktobra 2008. godine, Skupština općine je, na svojoj redovnoj sjednici održanoj januara 2026. godine, usvojila sljedeće:

PRIJEDLOG ODLUKE
O FORMIRANJU RADNE GRUPE ZA IZRADU NACRTA PLANA RADA SKUPŠTINE OPĆINE
PRIZREN ZA 2026. GODINU

Član 1

Ovom odlukom se formira i imenuje radna grupa za izradu Plana rada Skupštine općine Prizren.

Član 2

1. Radna grupa za izradu plana rada Skupštine općine sastojat će se od predsjedavajućeg Skupštine i po jednog člana iz svakog političkog subjekta zastupljenog u Skupštini općine, kako slijedi:

1.1., Predsjedavajući Skupštine

1.2., član iz PDK

1.3., član iz LVV

1.4., član iz LDK;

1.5., član iz BDP;

1.6., član iz AAK;

1.7., član iz KDTP;

1.8., član iz NISMA;

1.9., član iz GUXO

1.10., član iz NDS;

1.11., član iz VAKAT-a

1.12., član iz SDU i

1.13., član iz YTHP-a.

Član 3

Radna grupa ima zadatak da izradi plan rada Skupštine općine Prizren za 2026. godinu, u skladu sa važećim zakonom i podzakonskim aktima, i da ga dostavi na odobrenje Skupštini općine.

Član 4.

Ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon podnošenja nadzornom organu, u smislu člana 8., u vezi sa članom 9. Zakona br. 08/L-284 o administrativnom preispitivanju opštinskih akata, i nakon objavljivanja na službenim jezicima na službenoj web stranici opštine.

Predsjedavajući Skupštine
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediye Meclisi
No. 001/011 -
Tarih: Ocak 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 12. Maddesi, 1 ve 2. Fıkrası, d) noktası, 51. Maddesi, 2. Fıkrası ve 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 27. Maddesi, 1. Fıkrası, 58. Maddesi, 2. Fıkrası gereğince Belediye Meclisi ocak 2026 tarihinde düzenlediği toplantıda aşağıda yer alanları onayladı:

2026 YILINA İLİŞKİN PRİZREN BELEDİYE MECLİS ÇALIŞMA PLANININ TASARLANMASI
İÇİN ÇALIŞMA GRUBUN OLUŞTURULMASI İLE İLGİLİ ÖNERİ KARARIN GÖRÜŞÜLMESİ
VE ONAYLANMASI

Madde 1

İşbu karar ile, 2026 yılına ilişkin Prizren Belediye Meclis çalışma planının tasarlanması için çalışma grubu oluşturulmuş ve adlandırılmıştır.

Madde 2

1. Meclis Başkanı ve aşağıda belirtildiği üzere Belediye Meclisi temsil eden siyasi kuruluşlarından birer üye Belediye Meclis çalışma planının tasarlanması için çalışma grubun bir parçası olacaktır:

- 1.1. Meclis Başkanı,
- 1.2. PDK üyesi,
- 1.3. LVV üyesi,
- 1.4. LDK üyesi,
- 1.5. BDP üyesi,
- 1.6. AAK üyesi,
- 1.7. KDTP üyesi,
- 1.8. NISMA üyesi,
- 1.9. GUXO üyesi,
- 1.10. NDS üyesi,
- 1.11. VAKAT üyesi,
- 1.12. SDU üyesi, ve
- 1.13. YHTP üyesi

Madde 3

Çalışma Grubu yürürlükteki yasa ve aktlar doğrultusunda 2026 yılına ilişkin Prizren Belediye Meclis çalışma planını tasarlamakla ve aynısını Belediye Meclisinde onaylamak üzere sunmakla yükümlüdür.

Madde 4

Söz konusu karar Belediye Aktların İdari İncelemesi ile ilgili 08/L-284 sayılı yasanın 9. Maddesi ile bağlantılı olan 8. Maddeye istinaden denetleme organına iletdikten 30 gün sonra ve Belediyenin resmi web sayfasında resmi dillerde iletdikten sonra yürürlüğe girer.

Meclis Başkanı
Simir Krasniqi